

FEDERATA SHQIPTARE E NOTIT

PLANI STRATEGJIK 2025-2028

Plani Strategjik i FSHN, ndertohet ne vijim te kauzës tone per zhvillimin e notit shqiptar duke udhëhequr zhvillimin dhe organizimin e aktiviteteve kombëtare e nderkombetare te notit dhe perfaqësimin dinjitoz ne garat nderkombëtare.

STRUKTURA

Për veprimtarinë e saj FSHN drejtohet nga Presidenti dhe Komiteti Drejtues, duke u ndihmuar nga Komisionet dhe rrjeti i vullnetareve.

Organi administrativ i FSHSN perbehet nga Sekretari i Pergjithshem dhe Zyra e Finances. Ne zhvillimin e aktivitetit te saj FSHSN bazohet ne statutin e FSHN dhe rregulloret e ndryshme.

Pranë FSHN funksionojnë Komisionet: Kolegjiumi i gjyqtarëve; Këshilli i Trajnerëve; Komisioni Etikës dhe Apelit; Komisioni Financës, Komisioni Teknik, Komisioni Sportistëve

ANËTARËT

Anëtarët e Federatës Shqiptare të Notit, sikurse është sanksionuar në Statutin e saj, janë klubet sportive, shoqatat sportive, sportistët dhe individë të ndryshëm të njohur zyrtarisht prej saj.

I. MISIONI

Misioni i FSHN është :

Të zhvillojë, promovojë dhe të mbrojë sportin e notit në Shqipëri në përputhje me Statutin e saj; Te bashkëpunoje me partnere dhe grupe interesi per zhvillimin e ketij sporti. Të realizojë dhe konsolidojë bashkimin vullnetar dhe veprimtarinë e organizuar të klubeve, shoqatave e shoqërive sportive të notit, në territorin e Republikës së Shqipërisë, në të mirë të zhvillimit cilësor të këtij sporti dhe përfaqësimit dinjitoz të Republikës së Shqipërisë në veprimtari kombëtare e nderkombëtare. Të organizojë aktivitetet kombëtare dhe nderkombëtare te notit në Republikën e Shqipërisë; Të llojojë me partnerët nderkombëtarë për marrjen e së drejtës së organizimit të aktiviteteve të ndryshme nderkombëtare zyrtare;

II. VIZIONI

Rritja e cilësisë sportive, rritje e nivelit të ekipeve kombetare dhe zhvillimi i talenteve. Forcimi dhe zhvillimi i sportit te notit në Shqipëri, nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve drejtuese të FSHN dhe klubeve anëtare. Zgjerimi i komunitetit te notit, me përfshirjen e grupeve të interesit- shkolla, prindër, nxënës, mësues- për të rritur interesin ndaj sportit te notit dhe për ta bërë ate konkurues, krahasuar me sportet e tjera.

Puna jone do të përfshijë:

- Rritjen e numrit qe praktikojne sportin e notit.
- Rritjen e numrit të të rinjve qe praktikojne not kompetitiv dhe kalimin e tyre në ekipet e të rriturve.
- Inkurajimin e gjithpërfshirjes së pjesëmarrësve në aktivitetet e notit.
- Rritjen e ndërgjegjësimit për benefitet e sportit te notit dhe përfitimeve sociale prej tij, përtej anëtarësimit ekzistues.
- Zhvillimin dhe fuqizimin financiar të organizates tone dhe klubeve të notit.
- Zhvillimin e sportit elitare dhe talenteve.

FUSHAT PRIORITARE

1. Rritja e Pjesmarrjes :

- Rritja e pjesmarrjes se femres.

Femrat ne drejtim (Perfshi Sekretaren e Pergjithshme dhe Komitetin Drejtues) janë tre. Ambicja jonë është të rritet pjesëmarrja e tyre në të gjitha nivelet, specialiste, trajnere, sportiste dhe të krijojme kushtet dhe lehtësitë për pjesmarrjen e tyre ne aktivitete duke filluar nga te rinjte, te rriturit, deri tek senioret.

- Rritja e pjesmarrjes se te rinjve.
- Zhvillimi dhe përfshirja e sportit te notit ne shkolla, për të inkurajuar pjesëmarrjen e nxënësve të shkollave dhe për t'i drejtuar talentet drejt klubeve te notit, ne menyre qe të zhvillojnë potencialin e tyre.
- Rritje e numrit te te rinjve pjesmarrës ne garat kombetare, lokale dhe nderkombetare.
- Rritja e numrit te anetareve

Duke qene se anëtarësia jonë është aseti ynë më i madh, FSHN do të vijojë të përmirësojë tërheqjen e anëtarësimit përmes përmirësimit të shërbimeve e ofertave , dhe komunikimit dhe anëtarësimit. FSHN duhet të rrisë anëtarësimi i saj dhe të përmirësojë atraktivitetin ndaj sportit te notit, ne mënyrë që të sigurojë një të ardhme të zbatueshme. Do të shqyrtojmë funksionimin e sistemit të anëtarësimit, për të siguruar ofrimin e përfitimeve te metejshme për anëtarët.

2. Gjitheperfshirja:

- Vijimesi ne organizimin e kampionateve te te rinjve me grup moshë
- Organizimi kampionateve per amatore
- Organizimi i kampionateve per seniore
- Pjesmarrje e personave me aftesi ndryshe

3. Rritja e cilesise sportive .

- Mbështetje për talentet e reja dhe sportistëve shqiptarë pjesmarrës në aktivitetet ndërkombëtare, me aspiratën e përfaqesimit dinjitoz ne Kampionatet Mesdhetare, Europiane, Boterore.
- Këmbengulje dhe lobim për ngritjen e Akademisë Shqiptare të Notit
- Zhvillimi dhe përmirësimi i programeve të trajnimit, për të inkurajuar pjesëmarrjen e sa më shumë të rinjve dhe për t'i ndihmuar ata të arrijnë potencialin e tyre.
- Mbështetje për organizatorët e aktivitetëve të notit dhe zhvillimi i cilësisë së organizimit për të gjitha garat dhe kampionatet kombetare e ndërkombetare.
- Regjistrimi i kampionateve dhe garave lokale e rajonale në sistemin e swimrankings.

4. Promovimi dhe partneriteti

Pergatitja e nje programi te Sponsorizimit dhe Marketingut, per gjenerimin e te ardhurave shtese per te mundesuar investimin ne fushat tona prioritare

II. SYNIMET

- Zhvillimi i kapaciteteve te FSHN dhe mirefunksionimi i Komisioneve, per zhvillimin e specialisteve e programeve dhe rritjen e partneritetit e grupeve te interesit; Zhvillimi i kapaciteteve te klubeve dhe shoqatave per zhvillimin e tyre organizativ e funksional dhe planifikimin e organizimin e kampionateve lokale; Regjistrimi i garave lokale ne sistemin swimrankings. Lobimi me Pushtetin Vendor; Rritja e numrit te anetarësisë nepermjet antaresimit te pjesmarresve ne garat lokale/ te klubeve; Rritja e numrit te femrave ne levizjen sportive te notit ne te gjitha nivelet (sportiste, specialiste, drejtim); Perfshirja e personave me aftesi ndryshe; Organizimi i garave per seniore, amatore dhe shkolla.
- Zhvillimi i nje programi te cilësisë sportive nepermjet ngritjes se Akademise Kombetare te Notit dhe nje procesi stervitor te organizuar dhe funksional per pergatitjen e sportisteve te ekipeve perfaqesuese e talenteve te reja dhe rritjen e nivelit te perfaqesimit ne aktivitetet nderkombetare me ekipet dhe individet; Organizimi cilësor i aktiviteve kombetare dhe nderkombetare

III. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Objektivat strategjike jane mbeshetur ne **Analizen Swot**, e cila percakton qarte Cilat jane aspiratat per zgjerimin e organizates tone dhe qellimet konkrete ndaj te cilave ne mund te matim perparimin tone.

ANALIZA SWOT

- Pertej fushes ku kemi vepruar deri tani, si do te zgjedhim te zhvillohemi.
- Rruga qe do te zgjedhim te fitojme kundër konkurrenteve ne sportin tone, por edhe ndaj kercenimit te zhvillimit te sporteve te tjera
- Cilat aftesi jane te nevojshme per te ndertuar dhe per te fituar ne menyren tone te zgjedhur?
- Nevojen e ndertimit te nje sistemi menaxhimi, dhe veprimi per te ndertuar dhe zhvilluar sportin e notit.

STRENGTH: PIKAT E FORTA

- Rritja e cilësisë ne organizimin e garave kombetare dhe regjistrimi i tyre ne sistemin swimrankings.
- Rritja e numrit te notareve te rinj vitet e fundit.
- Kurset e trajnimit per trainerë, gjyqtare te organizuara vitet e fundit dhe rritjen e numrit te specialisteve te licencuar.
- Mbeshtetja e Prinderve ndaj te rinjve te involvuar ne klubet e notit.
- Krijimi i rrjetit te vullnetarëve, ku perfshihen specialiste dhe te rinj vullnetarë
- Programet e World Aquatics per rritje te popullaritetit te saj (nr. antareve , federata dhe sportiste)

WEAKNESSES- DOBËSITË

- Buxhetet e vogla.
- Numri i vogel i punonjësve.

- Mungesa e sportistëve notarë profesionistë (notarë të punësuar në fusha të tjera).
- Mungesa e mjediseve të federatës dhe klubeve (pishina trajnimi dhe pishina garash).
- Iniciativat e klubeve antare në organizimin e garave lokale.

OPPORTUNITIES – MUNDËSITË

Cilësia Sportive :

- ✚ Aktivitetet kombetare
Regjistrimi i garave lokale në sistemin swimrankings
- ✚ Aktivitetet nderkombetare:
Angazhimi i klubeve në organizimin e garave nderkombetare
- ✚ Organizimi i një turneu ndërkombëtar vjetor të FSHN
- ✚ Krijimi i Akademisë Shqiptare të Notit;
- ✚ Pjesëmarrje në aktivitetet Nderkombetare
- ✚ Mirefunksionimi i komisioneve të FSHN dhe Komisioneve të Klubeve

Masivizimi dhe rritja e reputacionit të FSHN

- Përfshirja në antaresinë e klubeve të gjithë sportistëve të niveleve të ndryshme, jo vetëm të ekipit përfaqësues në garat kombetare
- Angazhimi i klubeve në organizimin e garave lokale dhe regjistrimi i tyre në sistemin swimrankings

Partneriteti:

- Lobimi me Pushtetin vendor për mbështetje ndaj klubeve të notit
- Krijimi i grupeve të interesit në qytetet kryesore
- Partneritetet me organizatat Nderkombetare

THREATS- KËRCËNIMET

- Niveli i ulët organizativ i klubeve të notit antare të FSHN në organizimin e aktiviteteve lokale dhe zhvillimin e kapaciteteve të tyre.
- Mungesa e një pishine olimpike për zhvillimin e programeve strukturore si të ekipit kombëtar dhe talenteve, ashtu edhe për organizimin e garave
- Buxhetet e vogla
- Mungesa e ligjit të sponsorizimit dhe mundësia e gjetjes me vështirësi të sponsorëve edhe gjatë organizimit të ngjarjeve të rëndësishme.

OBJEKTIV 1

Zhvillimi I Kapaciteteve Të FSHN

OBJEKTIV 1I

Zhvillimi I reputacionit të FSHN dhe Cilësise Sportive

OBJEKTIV III

Promovimi

OBJEKTIV IV

Partneriteti

IV. BURIMET FINANCIARE

Intensiteti i realizimit të programeve të FSHN është në varësi të burimeve financiare të cilat janë të limituara. FSHN financohet me Grant /Transferte korrente nga Ministria perkatese e Sportit, përdorimi i të cilit fondi mbështetet në Udhëzimit të Përbashkët të MASR dhe Ministrisë së Finacave.

FSHN aplikon gjithashtu me projekte te ndryshme, duke pefituar projektin mbeshtetes OASP.

V. PLANI OPERATIV PER REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE

I. Zhvillimii I Kapaciteteve Të FSHN

1.1.Mirefunksionimi I Komisioneve

- Kryetaret dhe sekretaret per secilin komision
- Objektivat dhe Plani Operativ
- Mbledhje periodike
- Lidhje me kordinatorët e klubeve

II. Zhvillimi I reputacionit te FSHN dhe cilesise sportive

2..1 Zhvillimi I Klubeve anetare

- Planifikimi dhe organizimi i garave lokale
- Sistemi online i rezultateve te Kampionateve Kombetare
- Federimi dhe rritja e numrit te antaresimeve

2.2. Akademia Kombetare e Notit:

- a. Ndertimi i nje pishine olimpике nen drejtimin e FSHSH
- b. Ndertimi I planit te aktivitetit te akademise se notit
- Trajner i specializuar per zhvillimin e aktivitetit te akademise
- Trajnime dhe licencime te specialisteve (trajneret, gjyqtare, instruktoret, administratoret/ kordinatorët e klubeve)
Trajnim i ekipeve perfaqesuese dhe talenteve
- Trajnim i sportisteve të ekipeve përfaqësuese dhe talenteve.

2.3. Masivizimi i sportit të Notit:

Rritja e numrit te antareve/ sportiste, nëpërmjet regjistrimit te kampionateve lokale ne sistemin e garave të FSHN

2.4. Gjithperfshirja:

Rritja e numrit të femrave pjesmarrese në të gjitha nivelet *sportiste, specialiste, drejtim; Perfshirja e personave me aftesi ndryshe ne garat e organizuara; Organizimi i garave per seniore; Organizimi i garave per amatore

2..5 Organizimi Aktiviteteve Kombetare, sipas kalendarit vjetor

2.6. Organizimi Aktiviteteve Nderkombetare

- Turne per te rinj

- Turne per te Rritur
- Gara Europiane dhe Boterore
- Turne nderkombetare nga ana e klubeve.

2.7. Pjesmarrje ne aktivitetet Nderkombetare

- Mesdhetare
- Europiane
- Boterore
- Olimpiada

III. PROMOVIMI:

- Ndertimi i Data Baze me pjesmarres ne aktivitetet lokale
- Krijimi data baze me kordinatorët e shoqatave, klubeve
- Listim I sportistëve pjesmarres ne aktivitetet lokale dhe antaresim ne klube

Permiresimi i Website, nderveprues, i pasuruar nga veprimtarite e FSHN;

- Rrjetet sociale , TV, publikime dhe Promovimi i aktivitetëve vjetore; rritje e mardhenieve me mediat dhe numrit te publikimeve e artikujve pozitive.

IV. PARTNERITETI :

- Partneritet me te gjithë aktoret qe praktikojne, zhvillojne dhe mbeshhetsin sportin e notit.
- Bashkepunimi me organizatat partnere per realizimin e objektive dhe rritjen e qellimeve te FSHN
- Mbeshtetje nga sponsorë , marreveshje dhe raporte, etj..